



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:246/26, Datë: 27.02.2026

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimi Administrativ (MASHTI) Nr. 01B-03/2024 për vlerësimin e përshtatshmërisë së bartësve të programeve, Rregullorja (AKA) Nr. 04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master, Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe procesverbalit të mbledhjes 146 të mbajtur më 23.02.2026, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet** në nivel institucional Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren, për periudhën pesë (5) vjeçare (1 tetor 2026 deri me 30 shtator 2031).
- II.** Obligohet Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren që deri me 30 shtator 2026 të dorëzojnë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim planin për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- III.** Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

A R S Y E T I M

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren ka parashtruar kërkesë me Nr.prot.952/25, datë 31.07.2025, pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim për akreditim në nivel institucional.

Bazuar në nenin 16 të Rregullores (AKA) Nr. 03/2024 për procedurat e përzgjedhjes, angazhimit dhe kompensimit të ekspertëve të jashtëm dhe Rregulloren (AKA) Nr.04/2024 për Manualin e Akreditimit/Riakreditimit dhe Validimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit në Nivelin Bachelor dhe Master (tutje Manualit), AKA me datë 01.12.2025 ka organizuar vizitë me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren me qëllim të vlerësimit në nivel institucional.

Ekipi i vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka hartuar raportin përfundimtar të vlerësimit ku nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren është vlerësuar se përmbushë:

- Plotësisht nëntë (9) fushat e standardeve të akreditimit;
- Substancialisht dy (2) fushat e standardeve të akreditimit.

Duke ju referuar standardeve të plotësuara Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtar) ka rekomanduar që Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren të akreditohet për periudhën pesë (5) vjeçare, nga 1 tetor 2026 deri me 30 shtator 2031.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 146-të, të mbajtur me 23.02.2026 ka shqyrtuar kërkesën e Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe në rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit të cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtroj ankesë në Komisionin e ankesave të AKA, sipas paragrafit 11 të nenit 22 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga dita kur pala është njoftuar për vendimin e KShC-së. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*



Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Vendimi ju dërgohet :

- Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.